



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE PËR ARSIMIN DHE SPORTIN  
DREJTORIA E PROGRAMIMIT, STANDARDIZIMIT DHE HARMONIZIMIT TË  
KUADRIT RREGULLATOR

Nr. 4872/1 Prot.

Tiranë, më 10.8.2023

Lënda: Kthim përgjigje

## AKADEMISË SË STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE ✓

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 3, Tiranë

## Për dijëni: AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Adresa: Shëtitorja Murat Toptani, Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj me nr. 321 prot., datë 28.7.2023, protokolluar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS) me nr. 4872 prot., datë 28.7.2023, me lëndë "Kërkesë për informacion dhe interpretim nga MAS të pikës 2, të VKM-së nr. 338, datë 31.5.2023", lidhur me pyetjet që parashtroni, sqarojmë si më poshtë vijon:

Lidhur me pyetjen 1 dhe 2, të shkresës suaj, bëjmë me dije se në bazë të pikës 2, të vendimit nr. 338, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për mbylljen e veprimtarisë së Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe riorganizimin e njësive kryesore të saj", njësitet kryesore ekzistuese, Qendra Kërkimore e Enciklopedisë Shqiptare dhe Botimeve dhe personeli akademik i këtyre njësive, aktualisht pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, riorganizohen si njësi të kërkim-studimit pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, brenda datës 31 dhjetor 2023.

Njësitet e kërkim-studimit, janë njësitet sipas nenit 19, të ligjit nr. 53/2019, "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë". Sipas këtij neni, sipas nevojave, detyrave e problemeve në fushën e kërkimit, në përmbushje të rolit të saj, pranë Akademisë mund të ngrihen njësi të kërkim-studimit me aktivitet afatshkurtër e afatgjatë. Këto njësi janë autonome në realizimin e detyrave të tyre, mbajnë marrëdhënie me Kryesinë e Kryetarin dhe raportojnë pranë tyre. Sipas rëndësisë, problemeve e kohëzgjatjes, këto njësi ngrihen me akte të Asamblesë apo të Kryesisë për njësitet me afat deri në 2 vjet dhe me vendim të Këshillit të Ministrave për njësitet e tjera.

Sa më sipër, riorganizimi i njësive kryesore ekzistuese të Akademisë së Studimeve Albanologjike (ASA), i'u nënshtrohet rregullave dhe procedurave të përcaktuara në nenin

19, të sipërcituar. Sipas këtij neni është Akademia e Shkencave në Republikën e Shqipërisë autoriteti kompetent, i cili përgjigjet për riorganizimin/krijimin e njësive të kërkim-studimit, duke vlerësuar dhe aktivitetin e këtyre njësive, afatshkurtër apo afatgjatë. Në varësi të rëndësisë dhe kohëzgjatjes, Akademia e Shkencave vlerëson nëse këto njësi do të ngrihen me akte të Asamblesë apo të Kryesisë apo duhet të vijohen procedurat për krijimin e tyre me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në aktet e riorganizimit apo krijimit të këtyre njësive mund të përcaktohen mënyrat dhe format e organizimit dhe funksionimit të tyre.

Në lidhje me pyetjen 3, për transferimin e administratës së ASA-së, sqarojmë se në bazë të pikës 5, të vendimit nr. 338, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, në të cilën përcaktohet që *“Akademia e Studimeve Albanologjike të marrë masa që të vijojë ushtrimin e veprimtarisë së saj akademike, kërkimore-shkencore, administrative dhe financiare, deri në transferimin e plotë të njësive përbërëse pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.”*, transferimi i personelit të ASA-së do të bëhet pranë Akademisë së Shkencave.

Akademia e Shkencave, si një nga institucionet e ngarkuara për zbatimin e vendimit nr. 338, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, duhet të marrë masat dhe të ndjekë procedurat e nevojshme me qëllim transferimin e plotë të Akademisë së Studimeve Albanologjike, si nga ana e personelit administrativ, ashtu dhe nga ana e njësive të saj përbërëse dhe për personelin akademik dhe ndihmës akademik.

Akademia e Shkencave, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, pas transferimit të të gjitha kategorive të personelit do të bëjë trajtimin dhe sistemin e tyre brenda njësive të saj, sipas nevojave institucionale.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin,

**MINISTËR**

**EVIS KUSHI**

